

Testimi dhe gjurmimi i Covid-19

Pyetje të Shpeshta

Nuk ndihem mirë, nuk jam i/e sigurt nëse është Covid-19

Në rast se mendoni se mund të keni simptoma të Covid-19, duhet të merrni menjëherë këshilla nga [NHS 111 shërbimi online për Koronavirusin \(kontrolloni simptomat tuaja këtu\)](#)

Pasi kam kontrolluar simptomat e mia, mendoj se mund të kem Covid-19, çfarë duhet të bëj?

Ju duhet të izoloheni menjëherë dhe të caktoni një takim për të kryer testin në faqen <https://www.nhs.uk/conditions/coronavirus-covid-19/testing-for-coronavirus/> ose telefononi numrin 119 nëse nuk keni mundësi të përdorni internetin.

Çfarë duhet të bëj ndërsa jam duke pritur për testin / rezultatet e mia?

Ndërkohë që prisni të kryeni testin dhe të merrni rezultatet tuaja duhet të rri në izolim. Çdo person tjetër në shtëpinë tuaj duhet të vetë-izolohet për 14 ditë nga dita kur keni filluar të keni simptoma (pasi studimet kanë treguar që njerëzit mund të kenë COVID-19 deri në dy javë pa pasur simptoma). Ju duhet t'u tregoni njerëzve me të cilët keni qenë në kontakt të afërt gjatë 48 orëve të fundit se ju mund të keni Koronavirus.

Rezultatet e testit për Covid-19 janë negative

Në rast se testi rezulton të jetë negativ, ju dhe anëtarët e tjerë të familjes tuaj nuk keni më nevojë të izoloheni.

Rezultatet e testit për Covid-19 janë pozitive

Nëse rezultatet e testit për virusin janë pozitive, ju duhet të vazhdoni të qëndroni të vetë-izoluuar për **të paktën 7 ditë** nga fillimi i simptomave tuaja.

Anëtarët e familjes tuaj duhet të kryejnë 14 ditë vetë-izolim nga dita kur keni shfaqur simptomat për herë të parë. Shikoni këtu [për më shumë informacion se sa kohë ju duhet të vetë-izoloheni](#).

Çfarë ndodh më pas?

Brenda 24 orëve nga rezultati pozitiv i testit për covid-19 ju do të merrni një njoftim me mesazh në telefon ose me email nga *NHS Test dhe Trace*. Gjurmimi i të gjithë personave që mund të kenë qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me dikë me Covid-19 është një pjesë e rëndësishme e ndalimit të përhapjes së virusit.

Mesazhi në telefon ose emaili do të përmbajnë udhëzime se si të jepni të dhënat e personave me të cilët keni qenë së fundmi në kontakt të afërt. Kjo përfshin familjen tuaj ose persona të tjerë me të cilët jetoni, si dhe personat me të cilët keni qenë në kontakt të drejtpërdrejtë, ose në një distancë më të vogël se 2 metra, për më shumë se 15 minuta. Gjithashtu duhet t'i njoftoni ata për vendet ku keni qenë kohët e fundit.

Informacioni që jepni, do të dorëzohet nëpërmjet një faqe interneti të sigurt.

Nëse nuk keni akses në internet, ju do të telefonoheni nga një prej 25,000 gjurmuesve të kontaktit. Shërbimi do të përdorë një numër të vetëm të telefonit, i cili është: 0300 013 5000

Ekipi i gjurmimit të kontaktit do të përdorë informacionin që ju keni dhënë për të paralajmëruar ata që janë më të rrezikuar ndaj virusit se është e nevojshme që të vetë-izolohen. Personave që kontaktohen për arsye se rezultati i testit tuaj për Koronavirus është pozitiv, nuk do t'u tregohet identiteti juaj.

Ndihem mirë, por *NHS Test dhe Trace* më kanë thënë që kam qenë në kontakt me dikë me Covid-19

Kryerja e testit dhe gjurmimi është element kyç për të luftuar përhapjen e Covid-19. Në rast se ju është thënë se keni qenë në kontakt me një person që ka Koronavirus, ju duhet të vetë-izoloheni (qëndroni në shtëpi) për 14 ditë nga dita kur keni qenë në kontakt me personin për herë të fundit.

Mos u largoni nga shtëpia juaj për asnjë arsye - nëse keni nevojë për ushqim ose ilaç, porositini ato në internet ose me telefon, ose kërkojuni miqve dhe familjes që t'ju sjellin ato në shtëpinë tuaj.

A duhet që edhe personat e tjerë në familjen time të vetë-izolohen?

Personat me të cilët jetoni nuk kanë nevojë të vetë-izolohen nëse nuk keni simptoma.

Megjithatë, nëse jetoni me dikë që është i rrezikuar më shumë nga Koronavirusi, përpiquni të rregulloni që ata të qëndrojnë tek miqtë ose familja për 14 ditë, ndërsa ju jeni duke u vetë-izoluar. Nëse kjo nuk është e mundur, mund të gjeni [këshilla se si të shmangni përhapjen e Koronavirusit tek njerëzit me të cilët jetoni në faqen e NHS](#).

Në rast se më pas ndjeni se jeni duke shfaqur simptoma të Covid-19, duhet të merrni menjëherë këshilla nga ([NHS 111 shërbimi online për Koronavirusin \(kontrolloni këtu simptomat tuaja\)](#))

A duhet të vetë-izolohem vetëm një herë?

Jo domosdoshmërisht. Duke pasur parasysh rreziqet e ekspozimit ndaj personave të ndryshëm me Covid-19, mund t'ju kërkohet të vetë-izoloheni në më shumë se në një rast.

Nuk do të jem në gjendje të punoj nëse vetë-izolohem, çfarë ndihme është në dispozicion?

Nëse jeni vetë-izoluar për shkak të Covid-19 (për arsye se ju ose një person i cili banon në shtëpinë tuaj ka Koronavirus, ose sepse ju jeni këshilluar që keni rënë në kontakt me dikë me Koronavirus), ju mund të kërkonit Pagën Statutore për Sëmundje (£ 95.85 në javë, deri në 28 javë).

Nëse nuk klasifikoheni për Pagën Statutore për Sëmundje - për shembull, nëse jeni i vetëpunësuar ose fitoni nën Kufirin e Fitimit Më të Ulët prej £ 118 në javë - dhe ju këshillohet të vetë-izoloheni, mund të bëni një kërkesë për Kredi Universale.

Nëse jeni i vetëpunësuar, autoriteti juaj vendor mund të jetë në gjendje të mbështesë biznesin tuaj nëpërmjet fondit të tyre të vështirësive. Për më shumë informacion, kontaktoni këshillin tuaj vendor.

Informacioni mbi gamën e plotë të mbështetjes financiare në dispozicion të individëve dhe bizneseve që vetë-izolohen, gjendet në faqen e internetit të [HM Treasury](#).

Grupi i Angazhimit i Komunitetit të Londrës për Testimin dhe Gjurmimin